




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Duke u bazuar në nenin 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 2 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, në nenin 39 paragrafi 1.4, në nenin 49 paragrafi 2.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, si dhe bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur më 06.03.2013 miratoi këtë:

VENDIM

Për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2011 dhe 2012, në vitin fiskal 2013

I

Me këtë vendim lejohet bartja e mjeteve financiare nga të hyrat vetanake të pashpenzuara të vitit fiskal 2011 dhe 2012, në vitin fiskal 2013.

II

Mjetet e pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2011 dhe 2012 në shumë prej 213.605,53€ barten në:

Programi 160 Zyra e Kryetarit (nënprogrami 16027) në shumë prej 50.485,71€ në investime kapitale, në projektin: Shpronësimi (eksproprijimi) i tokës për interes publik (kodi i projektit 86211 në vitin 2012).

Programi 920 Arsimit dhe shkencë (nënprogrami 92730 Arsimit parashkollor dhe çerdhet) në shumë prej 5.214,83€ - Paga dhe mëditje.

Programi 920 Arsimit dhe shkencë (nënprogrami 93780 Arsimit fillor) në shumë prej 99.974,81€ Paga dhe mëditje.

Programi 920 Arsimit dhe shkencë (nënprogrami 94980 Arsimit mesëm) në shumë prej 57.930,18€ Paga dhe mëditje.

III

Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Kryetari i Komunës, ndërsa për implementimin e tij kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjilanit.

01.Nr. 16-20922
Gjilan, më 06.03.2013

Kuvendi i Komunës,

Izmi ZEKA, Kryesues

P.S. Ky vendim është anuluar.